



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 115/25 Datë: 13.02.2025

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Baçelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 134 të mbajtur më 06.02.2025, mori:

V E N D I M

- I.** Riakreditohet programi i studimeve të Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2025 – 30 shtator 2028):
 - *Gjuhë dhe Letërsi Frënge, MA 60 ECTS, me kuotën prej 20 student për vit akademik.*
- II.** Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III.** Obligohet Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 30.09.2025 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV.** Obligohet Fakultetin Filologjisë në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V.** Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Gjuhë dhe Letërsi Franceze, MA 60 ECTS	Teutë Blakçori

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës.

1. **Për programin e studimit; Gjuhë dhe Letërsi Franceze, MA 60 ECTS**, vizita me ekipin e ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Thomas Wulstan Christiansen, Anida Kisi dhe Nino Alavidze është organizuar më datë 10.12.2024.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelori dhe Master (tutje Manualit) ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht një (1), Substancialisht gjashtë (6) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 134 të mbajtur më 06.02.2025, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Filologjisë në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakulteti i Filologjisë në Universitetin e Prishtinës;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

